REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 29, datë 29.10.2026

PËR
MIRATIMIN E "PASQYRAVE FINANCIARE TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR TREMUJORIN E TRETË TË MBYLLUR MË 30 SHTATOR 2026"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja "l", nenit 53, pika 5, shkronja "ë" dhe nenit 62, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave" i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja "c", të nenit 8, pika 2, shkronja "l" të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e "Pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për tremujorin e tretë të mbyllur më 30 shtator 2026", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj — Kryetar

Shqipe Malaj — Sekretare

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al